



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 545/Prot.

Tiranë, më 04. 2021

Lënda: Dërgohen komente dhe sugjerime lidhur me Projektvendimin “Për miratimin e Planit Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025”.

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MIRËQËNIES SOCIALE

Adresa: Rruga e Kavajës

TIRANË

Në vijim të kërkesës tuaj, të përciell nëpërmjet shkresës nr. 1500 datë 19.03.2021, protokolluar me tonën nr.545 Prot., datë 25.03.2021, me lëndë “Kërkohen komente dhe sugjerime lidhur me Projektvendimin “Për miratimin e Planit Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi pasi u konsultua me Projektvendimin “Për miratimin e Planit Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025”, ju parashtron disa komente dhe sugjerime si më poshtë:

Së pari, konstatojmë se bashkëlidhur Draft Planit Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara, nuk është vendosur në dispozicion Aneksi. 1, i emërtuar “*Formati i Planit të Veprimit të përmbledhur*”, i cili citohet në faqen nr.61. Në këtë mënyrë Komisioneri, nuk mund të vlerësojë dhe të jap sugjerime në lidhje me aktivitete/masat e parashikuara për arritjen e objektivave specifike dhe fushave të politikës apo të bashkërendojë pasqyrimin e rekomandimeve të dërguara më shkresën nr. 76 prot, datë 12.01.2021.

Vihet re se, në pjesën e kuadrit ligjor dhe institucional në këtë Plan nuk është bërë një pasqyrim i Ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar dhe institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Garancitë ligjore dhe institucionale të parashikuara nga ky ligj dhe institucioni i Komisionerit, përbëjmë thelbin e garantimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, që sipas Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, parashikohen jo vetëm si parim (neni 3) por edhe si e drejtë më vete (neni 5).

Plani nuk jep një pasqyrim të saktë në lidhje me sistemin monitorues në fuqi në lidhje me përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara. Sipas Ligjit Nr. 93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Avokati i Popullit janë institucione monitoruese të zbatimit të këtij ligji. Ky parashikim ligjor propozojmë, të përmendet pasi nuk është evidentuar roli monitorues i Komisionerit.

Bazuar në praktikën e Komisionerit por edhe rekomandimet e dhëna nga organizatat e shoqërisë civile, një vëmendje e veçantë në këtë plan i duhet kushtuar harmonizimit të legjislacionit shqiptar me Konventën “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”. Paralelisht, me synimin për të përafruar dhe harmonizuar legjislacionin kombëtar me Konventën, duhet që ky proces harmonizimi të mos mbajë në fuqi diferenca në trajtim që bazohen në llojin e aftësisë së kufizuar.

Statistikat janë mjaft të rëndësishme për të monitoruar politikat dhe ligjet që mund të kenë pasoja diskriminuese. Për këtë arsye nevoja për të mbledhur dhe për të bërë publike të dhëna dhe statistika në lidhje me aftësinë e kufizuar paraqet një rëndësi të madhe. Në Raportin e Monitorimit me fokus të veçantë fëmijët në arsim, publikuar në vitin 2020, Komisioneri ka konstatuar se, dhe pse janë miratuar akte nga Këshilli i Ministrave mbi periodicitetin dhe mënyrën e raportimit të të dhënave, në lidhje me aftësinë e kufizuar, rezulton që këto akte kanë mbetur të pazbatuara ndër vite. Mospasja e një sistemi të mirë organizuar të mbledhjes së të dhënave, ndarjes së tyre sipas specifikave, unifikimit të matjes dhe raportimit të tyre, nuk lejon të kuptuarit qartë situatën faktike të diskriminimit në Republikën e Shqipërisë.

Për këtë arsye, në radhë të parë ky Plan duhet të nxisë zbatimin e VKM nr.708/26.08.2015 “Për llojet, periodicitetin dhe mënyrën e raportimit të të dhënave statistikore për aftësinë e kufizuar nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor”, si një akt i cili është në fuqi dhe më pas të vlerësohet nevoja për rishikimin e tij. Me qëllim vënien në zbatim të kësaj VKM-je, propozojmë që në planin e veprimit të parashikohet si aktivitet ose masë e veçantë: “Mbledhja dhe publikimi i të dhënave sipas treguesve të VKM për statistikat”. Afati për realizimin e këtij aktiviteti duhet të jetë që në vitin e parë të zbatimit të këtij Plani Kombëtar.

Është pozitive që Plani parashikon se në kuadër të planifikimit dhe zbatimit të aktiviteteve të parashikuara, duhet të kenë një vëmendje të veçantë grupet më të cënueshme që mund të përballen me diskriminimin për më shumë se një shkak. Adresimi i diskriminimit të shumëfishtë dhe atij ndërsektorial duhet të bëhet nëpërmjet parashikimit të aktiviteteve konkrete në planin e veprimit që adreson kategoritë e personave me aftësi të kufizuara të cilët mund të jenë viktimat e diskriminimit për më shumë se një shkak dhe jo t’i lihet adresimi i problematikave të këtyre grupeve vulnerabël planifikimit dhe zbatimit të aktiviteteve të parashikuara.

Përveç grupeve të identifikuara si më të cënueshme nga diskriminimi, propozojmë që të shtohen edhe personat me aftësi të kufizuara që i përkasin komunitetit LGBTI, duke vlerësuar pasqyrimin e rekomandimit të Komisionerit për shtimin e grupeve vulnerabel si pakicat rome dhe egjiptiane.

Në vlerësimin tonë, Plani duhet të ketë një qasje më të qartë për të adresuar diferencat që mund të vijnë për personat me aftësi të kufizuara që jetojnë në zona rurale, veçanërisht në zonat e thella rurale.

Me propozimet e dërguara nga KMD, lidhur me këtë Plan, kemi vlerësuar se një aspekt i rëndësishëm janë edhe afatet e përcaktuara për realizimin e masave/aktiviteteve. Duke u nisur nga fakti që disa prej masave/aktiviteteve ishin përcaktuar në afatet maksimale, KMD, rekomandoi që për sa është e mundur disa nga këto aktivitete të vendoseshin për t'u realizuar përgjatë dy viteve të para të Planit, e në mënyrë të veçantë për ato aktivitete në kuadër të objektivave të mbartura nga Plani i Veprimit 2016-2020 (*KMD është në pamundësi të vlerësimit nëse është marrë në konsideratë rekomandimi respektiv, pasi nuk na është përcjellë Aneksi nr.1*).

❖ **Komente dhe Sugjerime mbi Qëllimet e Politikave të Planit.**

Qëllimi i politikës nr.1 “Realizimi i aksesueshmërisë në mjedise, shërbime, transport dhe informacion për personat me aftësi të kufizuara”.

Aksesueshmëria mbetet një sfidë shumë dimensionale dhe sigurimi i aksesueshmërisë është një parakusht për eliminimin e pabarazive dhe mosdiskriminimin e personave me aftësi të kufizuara. Nga raporti i monitorimit që Komisionerit ka realizuar në lidhje me aksesueshmërinë e transportit publik vendor rezultoi se personat me aftësi të kufizuara vazhdojnë të përballen me transport të papërshtatur, e për rrjedhojë të mos kenë akses të plotë e pa barriera në shërbimet transportit urban në komunitetet ku ata banojnë.

Një nga arsyet që personat me aftësi të kufizuara vazhdojnë të përballen me një transport të papërshtatur, rezultoi të ishte mungesa e monitorimit të aksesueshmërisë, aplikimi i sanksioneve përkatëse ndaj kompanive të transportit që nuk respektojnë standartet e aksesueshmërisë. Të njëjtat konstatime rezultojnë edhe në kuadër të trajtimit të çështjeve ku Komisioneri nëpërmjet vendimmarrjes së tij ka konstatuar diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara për shkak të mungesës së aksesueshmërisë në transport. Në këto kushte vlerësojmë si emergjente forcimin e masave monitoruese dhe ndëshkimore për mungesën e aksesueshmërisë. E njëjta qasje duhet të aplikohet edhe për sigurimin e aksesueshmërisë së mjediseve, shërbimeve dhe aksesueshmërisë në informacion.

Rimbursimi i karburanteve dhe i transportit për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara të cilat janë problematika të konstatuara nga Komisioneri dhe të adresuara pranë autoriteteve përgjegjëse nëpërmjet rekomandimeve përkatëse, duhet të adresohen me prioritet, për më tepër që janë problematika të mbartura nga plani i mëparshëm i veprimit.

Pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, gjatë periudhës së pandemisë, është përcjellë problematika e mungesës së aksesueshmërisë së shërbimeve bankare online. Mendojmë se në këtë Plan krahas shërbimeve të parashikuara, duhet të ketë edhe objektiva që adresojnë aksesueshmërinë e shërbimeve bankare online për personat me aftësi të kufizuara.

Ky propozim është në përputhje me parashikimet e Konventën e Kombeve të Bashkuara “*Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara*”.

Qëllimi i politikës nr. 2 “Garantimi i aksesit të barabartë në sistemin e drejtësisë për të gjithë personat me aftësi të kufizuara”.

Në bazë të neneve 28 dhe 29 Ligjit nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor”, personat me çrregullime të shëndetit ndahen në dy kategori: Kategoria e parë, personat me çrregullime të shëndetit mendor, që kanë kryer një vepër penale, për të cilët gjykata kompetente ka vendosur mjekimin e detyruar në një institucion mjekësor të të paraburgosurve apo të të dënuarve që shfaqin çrregullime të shëndetit mendor gjatë vuajtjes së dënimit, si dhe për trajtimin e personave, për të cilët gjykata ka vendosur shtrimin e përkohshëm në një institucion mjekësor të posaçëm, për shkak se janë deklaruar të papërgjegjshëm nga gjykata. Kategoria e dytë, të dënuarit dhe të paraburgosurit që gjenden në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe që vuajnë nga çrregullime të shëndetit mendor.

Kategoria e parë e personave me çrregullime të shëndetit mendor në bazë të nenit 28 të Ligjit “Për shëndetin mendor”, nuk duhet të qëndrojnë në IEVP por në Institucione Mjekësore të posaçme. Institucionet mjekësore të posaçme, të përcaktuara në pikën 1 të nenit 28 të këtij ligji, janë pjesë e sistemit shëndetësor të integruar dhe jo pjesë e sistemit penitenciar.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, gjatë çështjeve që ka shqyrtuar ka evidentuar raste kur persona me aftësi të kufizuara, me masë mjekësore “Mjekim i detyruar” dhe “Shtrim i përkohshëm”, nuk duhet të jenë të akomoduar në institucionet (IEVP) në varësi të Ministrisë së Drejtësisë por duhet të trajtohen në institucione mjekësore të posaçme në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të cilën dhe aktualisht nuk është gjetur zgjidhje.

Pra, trajtimi i tyre mjekësor realizohet brenda ambienteve të IEVP-ve, duke i vendosur ata në pozita të pabarabarta me të sëmurët e tjerë mendorë, në mungesë të ofrimit të shërbimit të njëjtë mjekësor si atyre që kurohen në institucione shëndetësore publike, duke kufizuar lirinë

dhe të drejtat e sanksionuara me Kushtetutë, tej masës që përkon me vendimin gjyqësor të formës së prerë.

Gjithashtu, në kuadër të objektivit 3 *“Garantimi i respektimit të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në institucionet e dënimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare”*, dhe për sa parashikohet nga Ligji *“Për shëndetin mendor”*, propozojmë që të parashikohen aktivitete të veçanta për trajtimin e dy kategorive të mësipërme të personave të shëndetit mendor, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.

Pra, për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor, për të cilët gjykata ka dhënë masë mjekësore *“mjekim i detyruar në një institucion mjekësor”* dhe *“shtrim i përkohshëm në një institucion mjekësor”* duhet të parashikohet aktivitet i veçantë dhe të përdoret terminologjia e duhur duke shmangur përdorimin e termave *“i dënuar”* dhe për trajtimin e të dënuarve dhe të parburgosurve që vuajnë nga çrregullime të shëndetit mendor të parashikohen aktivitete në përputhje me standardet e parashikuara për trajtimin e personave që vuajnë nga çrregullime të shëndetit mendor.

Qëllimi i politikës nr.3 *“Rritja e pjesëmarrjes në tregun e punës dhe nxitja e mundësive të barabarta për punë të denjë për personat me aftësi të kufizuara”*.

Një nga problemet kryesore në lidhje me nxitjen e punësimit të personave me aftësi të kufizuara ka qenë se Ligji *“Për nxitjen e punësimit”* që detyron bizneset të punësojnë persona me aftësi të kufizuara, nuk shoqërohej nga aktet e nevojshme nënligjore që do të garantonin zbatueshmërinë e tij dhe në mënyrë të veçantë mungonte një strukturë ku do të paguheshin penaltetet. Ligji *“Për nxitjen e punësimit”*, ka një kapitull të posaçëm për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, duke parashikuar kuota punësimi për personat me aftësi të kufizuara nga punëdhënësit e sektorit privat dhe publik. Çdo kompani private apo institucion publik me më shumë se 24 punonjës, duhet të punësojë një person me aftësi të kufizuara për çdo 25 punonjës dhe dy në 75 punonjës. Megjithatë, penaltetet në fuqi për punëdhënësit që nuk përmbushin këto kuota nuk janë zbatuar deri tani.

Bizneset sociale apo qendrat që ofrojnë terapinë okupacionale (occupational therapy) duhet të mbështeten dhe të lidhen me tregun e punës dhe me biznese. Kjo do të krijonte një partneritet social me bizneset dhe do ulte kostot. Modele të tilla partneritetesh ka në Evropë dhe prodhojnë sistemin e dy niveleve. Pra, në bizneset sociale apo qendrat e rehabilitimit personat me aftësi të kufizuara marrin aftësimin për të kaluar tek bizneset. Periudha që personat trajnohen mund të shërbej edhe për të thyer barrierat paragjyquese. Në këtë mënyrë gjithashtu partneriteti për punësimin e personave me aftësi të kufizuara bëhet i strukturuar duke bashkuar qendra rehabilitimi, biznese sociale, arsim profesional, zyrat e punës dhe bizneset. Bizneset që nuk paguajnë penaltetin, nuk angazhohen në partneritete sociale do duhet të përjashtohen nga

prokurimet publike. I njëjti model mund të ndiqet edhe në sektorin shtetëror. Në kuadër të kësaj administrata publike duhet të jetë shembull për zbatimin e Ligjit “Për nxitjen e punësimit”.

Disa propozime për masa/aktivitete lidhur me këtë qëllim të politikës, të adresuara edhe me parë nga Komisioneri janë:

- Përmirësimi i mekanizmit të monitorimit dhe vjeljes së penaliteteve që rrjedhin nga moszbatimi i kuotave të punësimit të PAK.
- Zyrat e punësimit duhet të informojë bizneset me programet e nxitjes së punësimit dhe përfitimet që ata mund të kenë në rastet e punësimit të të rinjve me aftësi të kufizuara nëpërmjet këtyre programeve.
- Krijimi i një partneriteti të strukturuar për punësimin e personave me aftësi të kufizuara duke përfshirë qendrat e rehabilitimit, bizneset sociale, arsimin profesional, zyrat e punës dhe bizneset.
- Zyrat pranë Bashkive, që merren me çështjet e punësimit, të koordinohen me zyrat rajonale të punës (Punësim i ndërmjetësuar)
- Bizneset që nuk zbatojnë Ligjin “Për nxitjen e punësimit” lidhur me kuotën e punësimit të PAK, të përjashtohen nga prokurimet publike.
- Monitorimi i administratës publike mbi zbatimin e parashikimeve ligjore lidhur me punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Qëllimi i politikës 4: “Sigurimi dhe ofrimi i arsimit gjithëpërfshirës dhe cilësor për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara”.

Vlerësohet si pozitive fakti që arsimit special dhe institucionet e tij synohen që të kthehen në qendra burimore, pasi kjo është një sfidë e hershme. Nëse arsimit dhe institucionet e arsimit special kthehen në qendra burimore, ulen kostot dhe individët me aftësi të kufizuara mund të jetojnë në banesat e tyre. Modele Evropiane se si funksionojnë qendrat burimore ka, ato japin trajnime bazë për të jetuar i pavarur duke mundësuar më pas jetesë të pavarur të individëve me aftësi të kufizuara. Trajnimi bazë është (lëvizshmëria leximi në formate të përshtatura dhe trajnim mbi funksionet bazike të jetës.) Vlerësojmë se ky është një moment që duhet të adresohet në këtë Plan.

Shkollat speciale duhet të jetë i orientuar drejt më shumë orëve didaktike në praktika profesionale. Eksperienca evropiane tregon se personat me aftësi të kufizuara intelektuale kanë shanse reale punësimi në aktivitete si kopshtari, kuzhinë dhe në përgjegjësi në aktivitete artizanale.

Është me rëndësi që ti kushtohet gjithashtu vëmendje mësuesve ndihmës në arsimin profesional. Puna dhe arsimimi profesional do të rrisnin mundësinë e vetë punësimit. Një aspekt tjetër i rëndësishëm është që të realizohet lidhja e shkollave speciale me arsimin profesional.

Disa propozime për masa/aktivitete lidhur me këtë qëllim të politikës, të adresuara edhe me parë nga Komisioneri janë:

- Fuqizimi ekonomik përmes lidhjes së arsimit special me kurset profesionale
- Kthimi në praktikë i arsimit special në qendra burimore me fokus aftësimin për jetën për personat me aftësi të kufizuara të intelektit, duke identifikuar një prej shkollave speciale për ta pilotuar si praktikë e cila më pas mund të aplikohet edhe për shkollat e tjera speciale.
- Trajnimi i mësuesve të shkollave speciale për të ofruar trajnime me fokus aftësimin për jetën.
- Mësuesit e shkollave speciale të mund të punojnë si mësues ndihmës në arsimin gjithpërfshirës.
- Në kurrikulat e Universiteteve, në degën e ciklit të ulët, duhet të përfshihen programe për aftësimin e mësuesve të ardhshëm, në mënyrë që ata të përgatiten për të punuar me fëmijë me aftësi të kufizuara.

Qëllimi i politikës 5 : “Përmirësimi i cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet shërbimeve/përfitimeve të aksesueshme, të përballueshme financiarisht dhe që kanë në qendër klientin”.

Edhe pse reforma e vlerësimit të personave me aftësi të kufizuara ka vite që ka nisur ende vazhdon një praktikë që mban në fuqi trajtime të diferencuara bazuar në llojin e aftësisë së kufizuar. Pra edhe pse reforma do duhet të sillte një përfshirje më të gjerë dhe përfitime në bazë të nevojave, pa diskriminim, në praktikë ende sot kjo nuk ndodh. Zbatimi i reformës së vlerësimit vazhdon të mbetet i kufizuar edhe në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku po pilotohet, pasi personat me aftësi të kufizuara edhe në këto njësi vazhdojnë të vlerësohen mbi bazën e dy modeleve, atij të vjetrit sipas ligjeve të posaçme në fuqi dhe vlerësimit të ri bio-psiko-social.

Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në Komentin e Përgjithshëm Nr.6 (2018) mbi barazinë dhe mosdiskriminimin, në pikën 12, të tij shprehet se: “Barazia dhe mosdiskriminimi janë parime dhe të drejta. Konventa u referohet atyre në nenin 3 si parime dhe në nenin 5 si të drejta. Ato janë gjithashtu një mjet interpretues për të gjitha parimet dhe të drejtat e tjera të mishëruara në Konventë. Parimet/e drejta për barazi dhe mosdiskriminim janë gur themeli i mbrojtjes ndërkombëtare të garantuar nga Konventa. Promovimi i barazisë dhe

trajtimi i diskriminimit janë detyrime ndërsektoriale të realizimit të menjëhershëm. Ato nuk i nënshtrohen realizimit progresiv.”

Edhe pse i gjithë sistemi i vlerësimit të personave me aftësi të kufizuara është duke u reformuar, kjo nuk duhet të përbëjë justifikim për ekzistencën e diferencave në trajtim të personave me aftësi të kufizuara të bazuara në llojin e aftësisë së kufizuar. Jo vetëm kaq, por në kuadër të procesit të reformimit të vlerësimit të personave me aftësi të kufizuara duhet të eliminohen diferencat në trajtim që ekzistojnë midis personave me aftësi të kufizuara dhe që bazohen në llojin e aftësisë së kufizuar. Vendimi i Këshillit të Ministrave me nr. 182, datë 26.02.2020 vazhdon të mbajë në fuqi diferenca në trajtim midis kujdestarëve të personave që gëzojnë statusin si paraplegjik/tetraplegjik dhe kujdestarëve të personave të tjerë me aftësi të kufizuara. Në lidhje me këtë çështje Komisioneri ka dërguar një rekomandim të posaçëm për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me qëllim marrjen e masave për të eliminuar diferencat në trajtim të bazuara në llojin e aftësisë së kufizuar.

Bazuar në nenin 4, pika 4 të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, asnjë nga kjo Konventë nuk duhet të prekë ato dispozita që janë më të favorshme për realizimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara që mund të parashikohen në legjislacionin e shteteve apo në ligjin ndërkombëtar në fuqi për atë shtet. Në frymën e këtij parashikimi të Konventës, eliminimi i pabarazive në trajtim për personat me aftësi të kufizuara duhet të realizohet në mënyrë të menjëhershme duke mos lejuar humbjen e të drejtave të njohura tashmë nga legjislacioni në fuqi.

Bashkitë janë ato që duhet të mbështesin me shërbime personat me aftësi të kufizuara. Një gjë e tillë e cila mund të konsiderohet si një kosto e shtuar, në terma afatgjatë krijon persona me aftësi të kufizuara të pavarur dhe ul koston që shteti duhet të paguaj për ta në të ardhmen. Një aspekt i rëndësishëm në drejtim të zbatimit të praktikë të këtij Plani është aftësimi dhe ekspertiza e njësisë të vetëqeverisjes vendore. Për këtë arsye trajnimi i Bashkive se si të tërheqin fonde për t'i përdorur në shërbim të komunitetit të personave me aftësi të kufizuara në komunitetet ku jetojnë, është shumë i rëndësishëm. Monitorimi i funksionimit të fondit social që tashmë është i strukturuar paraqet një rëndësi me qëllim për të siguruar zbatimin efektiv të tij. Mënyra se si do shpërndahen fondet, por edhe shtrirja gjeografike do tregojnë efikasitetin e tij. Për aq kohë sa Bashkitë nuk do tërheqin fonde vendoset në rrezik zbatimi i këtij Plani. Bashkitë duhet të aftësohen jo vetëm për të tërhequr fonde.

Disa propozime për masa/aktivitete lidhur me këtë qëllim të politikës, të adresuara edhe me parë nga Komisioneri janë:

- Njësitë e vetëqeverisjes vendore të trajnohen për të përdorur dhe tërhequr fonde nga fondi social.

- Njësitë e vetëqeverisjes vendore të trajnohen për të ofruar shërbime komunitare me fokus trajnimin e personave me aftësi të kufizuara për jetesë të pavarur.
- Ofrimi i shërbimeve për të gjitha kategoritë sipas nevojave specifike.

Qëllimi i politikës 7: “Garantimi i përfshirjes së plotë të personave me aftësi të kufizuara në jetën publike dhe politike në Shqipëri dhe mundësimi i mbrojtjes së interesave të tyre”.

Përpjekjet për të nxitur pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në jetën kulturore janë sporadike. Legjislacioni nuk lejon shitjen e biletave nga çdo organizatorë, pasi konsiderohet shfaqje me qëllim fitimin. Për këtë arsye nisma të cilat kanë karakter social dhe ndërgjegjësues në lidhje me çështjet e aftësisë së kufizuar, nuk do mund asnjëherë të prodhojnë gjithëpërfshirjen e artistëve me aftësi të kufizuara, dhe as të krijojnë mundësi për gjenerim të ardhurash. Në këto kushte propozohet angazhimi aktiv i institucioneve kulturore të vendit në menaxhimin nga ana vetë dhe nën përgjegjësinë e tyre të shfaqjeve të tilla. Nga ana tjetër organizatat e shoqërisë civile marrin për sipër koordinimin, kontaktet me të interesuarit, ofrimin e shërbimeve mbështetëse, vlerësimin psiko-social dhe marrin për sipër rolin e sensibilizimit të publikut të gjerë. Në këtë mënyrë institucionet kulturore do prodhojnë bileta edhe nga shfaqje të karakterit social, duke krijuar mundësi zhvillimi të shfaqjeve të këtilla me një kualitet më të lartë.

Propozim për masa/aktivitete lidhur me këtë qëllim të politikës, të adresuara edhe me parë nga Komisioneri janë:

- Krijimi i një bashkëpunimi të strukturuar me kompetenca të ndara midis institucioneve kulturore dhe organizatave të shoqërisë civile, me qëllim parashikimin e ditëve të rezervuara në kalendarin e aktiviteteve kulturore/artistike të këtyre institucioneve, për shfaqje me karakter social dhe ndërgjegjësues, shfaqje/aktivitete të cilat do të jenë nën menaxhimin e institucioneve.

Qëllimi i politikës 8: “Krijimi i sinergjive ndërmjet institucioneve dhe sektorëve të ndryshëm për nxitjen dhe monitorimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në mënyrë të plotë, të vazhdueshme dhe të qëndrueshme”.


Për fat të keq, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 708, datë 26.8.2015 “Për llojet, periodicitetin dhe mënyrën e raportimit të të dhënave statistikore për aftësinë e kufizuar nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor”, rezulton të mos ketë gjetur zbatim në praktikë. Aktiviteti i parashikuar për rishikimin e kësaj VKM për statistikat paraqet një rëndësi të veçantë. Në kuadër të procesit të rishikimit të këtij akti nënligjor propozojmë që përveç sa është parashikuar në lidhje me përputhshmërinë e indikatorëve të rishikuar me SDG,

të mbahet parasysh Komenti i Përgjithshëm Nr. 6 (2018) mbi Barazinë dhe Mosdiskriminimin, miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, i cili përmban parashikime në lidhje me statistikat dhe mbledhjen e të dhënave.

Në kuadër të nxitjes së bashkëpunimit, monitorimit dhe vlerësimit të çështjeve të aftësisë së kufizuar, sugjerojmë që në këtë pjesë të planit të veprimit të parashikohet një aktivitet në lidhje me zbatimin e rekomandimeve dhe vendimeve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të cilat rezultojnë në jo pak raste të pazbatuara.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI


ROBERT GAJDA

